



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 8131. Prot

Tiranë, më 15.11.2021

URDHËR

Nr. 255, Datë 15.11.2021

“PËR
MIRATIMIN E PROJEKTEVE NË TURIZËM QË PËRFITOJNË MBËSHTETJE
FINANCIARE NGA BUXHETI I SHTETIT”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, të pikës 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në turizëm”, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve;

URDHËROJ:

1. Miratimin e projekteve të përzgjedhura nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, që do të përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, si më poshtë vijon:

- “Tradita që kthehet në markë” - Subjekti “Qendra Dritare”;
- “Krijimi i Identitetit Korporativ & Brand Book për 4 Bashki” - Subjekti “Ardit Koleci”;
- “Në zbulim të kulinarisë shqiptare” - Subjekti “Briken Rrozhani”;
- “Rritja e Promocionit dhe Përmirësimi i Shërbimeve Turistike në Bashkinë Përmet” - Subjekti “Vjosa Explorer”;
- “Promovimi i kalave dhe njohja me historinë e tyre” - Subjekti “Fatjon Sino”;
- “Shije dhe eksperiencia nga Jugu i Shqipërisë” - Subjekti “Caravan Horse Riding Albania/ C-Adventures & Tours”;
- “Nxitja e angazhimit rinor në promovimin e turizmit” – Subjekti “Act Now; Albania”.

2. Ngarkohet Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, për publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të listës së projekteve përfituese të financimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

